



BASHKIA BULQIZE

Funksionet e bashkise në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Sherbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit:

1. Sigurimin në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit ngandotja.
2. Sigurimin në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Të drejtat, përgjesitë dhe misionin e bashkisë.

1. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera.
2. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit.
3. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike.
4. Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj.
5. Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror.
6. Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit.
7. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit:

1. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
5. Ndriçimin e mjediseve publike.
6. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
7. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
8. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.